



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 06.02.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 16.01.2020 dhe 23.01.2020.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:10 dhe mbaroi në orën 12:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 11. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 5. Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit.*
- 6. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 7. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 11. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Përfaqësues të misioneve ndërkombëtare.*

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 16.01.2020 dhe 23.01.2020.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Siç jeni në dijeni, sot Këshilli fillon mbledhjen e radhës së datës 06.02.2020.

Në rend të ditës janë 7 çështje për t'u diskutuar.

Çështja e parë ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 16.01.2020, 23.01.2020.

Çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin projektvendimit mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve.

Çështja e tretë ka të bëjë me projektvendimin për detajimin e buxhetit në shpenzime kapitale për sistemin gjyqësor për vitin 2020.

Çështja e katërt ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për daljen nga përdorimi të aseteve në pronësi të disa gjykatave.

Çështja e pestë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për caktimin në detyrë të znj. {...}.

Çështja e gjashtë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë.

Dhe çështja e fundit ka të bëjë për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Atëherë, kalojmë me çështjen e parë, e cila ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 16.01.2020, 23.01.2020. Procesverbalet ju janë kaluar nga administrata. Nëse keni ndonjë diskutim lidhur me përmbajtjen e tyre, nëse jo, atëherë kalojmë në votim të procesverbaleve.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 16.01.2020 dhe 23.01.2020.

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtij procesverbali Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në fakt, doja t'ju bëja me dije që Këshilli i Lartë Gjyqësor, prej 24 orësh ka një faqe të re elektronike, e cila për herë të parë do na mundësojë aplodimin edhe të procesverbaleve audio të mbledhjeve plenare. Në këto momente, nga ana e administratës po merren masa që të aplodohen ato procesverbale që nuk kërkojnë anonimizimin e të dhënave. Ndërkohë që po merren masa dhe është kërkuar asistencë Misionit EURALIUS lidhur me mundësinë, duke qenë se e kanë shprehur vetë këtë opsion, mbi mundësinë e pajisjes që mund të na lejonte anonimizimin e informacioneve sensitive për vendimmarrjet tona.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 06.02.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:10 dhe mbaroi në orën 12:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|------------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |

11. Marçela Shehu

(anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 5. Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit.*
- 6. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 7. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 11. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Përfaqësues të misioneve ndërkombëtare.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me

shqyrtimin e projektvendimit “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

Siç jeni në dijeni, ky është një nga projekt-aktet e tjera shumë të rëndësishme që Këshilli do marri në shqyrtim. Kuptohet, përmes këtij projekt-akti do bëhet e mundur që të kemi një funksionalizim më të plotë të Gjykatës së Lartë por gjithashtu edhe fuqizimin e Gjykatës së Posaçme për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar.

Ky projekt-akt është i diskutuar jo vetëm brenda Komisionit por është marrë asistencë edhe nga misionet dhe projektet që asistojnë Këshillin, i është nënshtruar një konsultimi edhe me trupën gjyqësore. Kështu që, përmes miratimit të këtij projekt-akti, Këshilli sot i hap rrugën promovimit të gjyqtarëve më profesionistë dhe më me integritet në të gjithë gjykatat e vendit.

Për më shumë detaje, unë do doja t’ia jepja fjalën zotit Ilir Toska, për relatinin e projekt-aktit.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, në vijim të fjalës së Kryetares, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, duke përmbyllur kuadrin ligjor për promovimin e gjyqtarëve në të gjitha shkallët në Republikën e Shqipërisë.

Projektvendimi përmban 10 krerë.

Në kreun e parë përcaktohet qëllimi, fusha e zbatimit dhe subjektet e këtij vendimi.

Në kreun e dytë përcaktohet kuadri ligjor ku listohen një sërë aktesh ligjore, sipas të cilëve do duhet të interpretohet dhe zbatohet projektvendimi për ngritjen në detyrë.

Në kreun e tretë jepen përkufizimet për termat që përdoren në vendim.

Në kreun e katërt parashikohen hapat dhe kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve, konkretisht, në seksionin “A” përcaktohen rregulla të përgjithshme për renditjen; në seksionin “B” përcaktohet hapi i parë, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve; në seksionin “C” parashikohet hapi i dytë, kriteri dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve; në seksionin “Ç” parashikohet hapi i tretë, kriteret dhe përparësitë e

renditjes së kandidatëve.

Në vijim në kreun pesë, janë rregulla të përgjithshme për procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve, ku në seksionin “A” rregullon në mënyrë të hollësishme fillimin e procedurës së përzgjedhjes dhe detyrimet që ka çdo anëtar i Komisionit ose i Këshillit për dorëheqjen apo më tej edhe për caktimin re relatorit. Jepen në seksionin “B” të drejtat e kandidatit sa i përket në aspektin e një procesi të rregullt ligjor. Në seksionin “C” rregullohen afatet dhe mënyra e llogaritjes së tyre në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve. Në seksionin “Ç” parashikohen rregulla të detajuara sa i përket njoftimeve mes Këshillit dhe kandidatëve.

Në kreun gjashtë janë fazat e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve, pra rregulla në lidhje me fazat e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve. Konkretisht, në seksionin “A” përcaktohen procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për ngritjen në detyrë që realizohet në tre faza: veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit, përfshirë kur është rasti edhe për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatit që ka qenë i komanduar në një institucion brenda sistemit të drejtësisë dhe ky i fundit nuk ka bërë vlerësimin etik dhe profesional; faza e dytë është shqyrtimi dhe miratimi nga Komisioni i projektvendimit të renditjes së kandidatëve ose i projektvendimit paraparak të propozimit për emërim; dhe faza e fundit është shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projektvendimit të renditjes së kandidatëve ose i projektvendimit paraparak të propozimit për emërim. Seksioni “B” përcakton procedurat e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë. Seksioni “C” përcakton rregullat për shqyrtimin dhe miratimin nga Komisioni i projektvendimit të renditjes së kandidatëve ose i projektvendimit paraparak të propozimit për emërim të përgatitur nga relatori dhe seksioni “Ç” rregullat e shqyrtimit nga Këshilli të projektvendimit të përgatitur nga relatori dhe kaluar në mbledhjen plenare nga ana e Komisionit.

Në kreun e shtatë jepen rregulla për vendimin për renditjen e kandidatëve dhe për vendimin paraparak të propozimit për emërim si dhe e drejta e ankimit.

Në kreun e tetë parashikohet vendimi për ngritjen në detyrë, që është akti final i procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë me përjashtim të Gjykatës së Lartë.

Në lidhje me këtë, rregullimet jepen në kreun e nëntë, që është vendimi përfundimtar i propozimit për emërim në Gjykatën e Lartë.

Në kreun e fundit, në kreun e dhjetë, janë dispozitat për periudhën kalimtare referuar nenit 25, paragrafi 3, të ligjit nr. 48/2019, që ka parashikuar një procedurë paksa të ndryshme sa i përket kriterëve për renditjen e kandidatëve për periudhën tranzitore.

Projekt-aktin e kemi diskutuar. Është përgatitur në bashkëpunim me dy misionet USAID dhe EURALIUS dhe e kemi diskutuar edhe bashkërisht paraprakisht. Mund t'ju bëj me dije që referuar diskutimit që ne bëmë ditën e djeshme bashkërisht, misionit EURALIUS i është kërkuar një opinion lidhur me fjalinë e parafundit që është shtuar në shkronjën “f” të pikës 7, tek “Përkufizimet”. Po kështu, i është kërkuar opinion ligjor për pikën 77, në lidhje me vlerësimin e dytë, kush do të konsiderohet vlerësim i dytë, në kuadër të kriterit të renditjes së dy vlerësimeve të mëparshme, sa i përket kandidatëve që kanë qenë të komanduar.

Në këto kushte, nëse çmuni që të vijojmë diskutimet... Unë vlerësoj që nëse ka ndonjë diskutim tjetër që është i nevojshëm apo mendoni se do duhet të kërkohet opinion nga misionet, të diskutohet. Nëse jo, atëherë të kalojmë në parim projektvendimin dhe të presim dy komentet që mund të na vijnë për të dy çështjet.

Naureda Llagami: Atëherë, lidhur me propozimin e bërë nga zoti Toska, duke qenë se është një akt shumë i diskutuar nga ana jonë, jeni dakord që ta kalojmë në parim miratimin e rregullores, për të lënë një rezervë vetëm për dispozitat që kemi kërkuar opinion dhe asistencë nga ndërkombëtarët, me idenë që ne nesër ose në momentin më të parë që ato do prezantojnë opinionet, të futemi për ta kaluar më pas nen për nen.

Brunilda Kadi: Që ta kuptojmë. Sot e kalojmë në parim dhe nesër nen për nen? – ky ishte propozimi? Se nuk e kuptuam.

Ilir Toska: Po pra. Keni ndonjë objeksion që do duhet të kërkohet? A keni ndonjë gjë që do duhet ta diskutojmë, e diskutojmë. Nëse s’ka ndonjë gjë tjetër përveç atyre që kemi diskutuar dhe janë reflektuar...

Brunilda Kadi: Okej. Ideja që ne dje deri vonë kemi punuar dhe ramë dakord për ato që ishin të diskutueshme për të marrë mendim. Mua nga ana tjetër nuk më bën sens që

sot e miratojmë në parim dhe nesër nen për nen. Nuk e kisha dëgjuar ndonjëherë këtë, prandaj dhe e bëra pyetjen që, ky ishte propozimi? Se më duket pa sens. Mendoj që duhet të priten... përderisa ne vlerësuam që të marrim opinionin e misioneve, duhet të presim përgjigjen e tyre dhe të vijojmë, se më duket pa kuptim që e ndajmë në dy faza.

Naureda Llagami: Okej. Atëherë, duke qenë se misionet i kemi këtu prezent.

Kemi nga EURALIUS-i këtu?

Po!

Kur është e pritshme që të sillni opinionin tuaj?

Përfaqësuesja e EURALIUS (pa mikrofon): Përshëndetje të nderur!

Ne jemi në fazën e përgatitjes së opinionit ligjor. Besoj brenda ditës së nesërme do të jetë gati për t'ju vënë në dispozicion.

Naureda Llagami: Të nesërmen?

Përfaqësuesja e EURALIUS (pa mikrofon): Ky ka qenë edhe afati që na keni lënë nga ana e institucionit tuaj.

Naureda Llagami: Deri nesër paradite.

Atëherë, me ardhjen nesër të opinionit, ndoshta Këshilli për shkak të rëndësisë dhe urgjencës që ka, do mblidhemi mbas dite për ta kaluar për të miratuar rregulloren.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 06.02.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin e buxhetit në shpenzime kapitale për sistemin gjyqësor, për vitin 2020”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për daljen nga përdorimi të aseteve në pronësi të disa gjykatave”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:10 dhe mbaroi në orën 12:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)

- | | |
|-----------------------------|------------------|
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 5. Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit.*
- 6. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 7. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 11. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Përfaqësues të misioneve ndërkombëtare.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin e buxhetit në shpenzime kapitale për sistemin gjyqësor, për vitin 2020”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik,

Administrimit dhe Buxhetit.

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për daljen nga përdorimi të aseteve në pronësi të disa gjykatave”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës.

Kalojmë tek çështja e tretë e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit lidhur me detajimin e buxhetit në shpenzimet kapitale për sistemin gjyqësor, për vitin 2020. Ky projekt-akt është përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit dhe ftohet drejtoresha Luljeta Laze të bëjë relatimin në mënyrë të detajuar, të këtij projekt-akti, për të gjithë anëtarët e Këshillit.

Brunilda Kadi: Kam një pyetje.

Përpara se të vijohet me relacionin, unë kisha një pyetje për Kryetaren por edhe me pjesën e administratës që merret me dërgimin e materialeve.

Materiali për këtë pikë të rendit të ditës na ka ardhur dje, mbas dreke, dhe siç e dimë të gjithë kemi qenë duke punuar deri vonë. Nuk e kuptoj arsyen, se me sa kemi informacion, ky projekt-akt është përgatitur që javën e kaluar dhe, pse nuk na ka ardhur materiali që ta lexonim paraprakisht? Se nëse Komisioni ose ata që kanë bërë relacionin kanë pasur kohën e duhur që kanë arritur në një konkluzion, ne të tjerët që do marrim vendimin, si mund t’i shqyrtojmë këto, këtë vendimin? Se mendoj që është vendimi më i rëndësishëm që merr Këshilli për administrimin e buxhetit. Detajimi i buxhetit për shpenzimet është mendoj vendimi më i rëndësishëm që merr Këshilli dhe unë që të japë votën, për iks apo për ipsilon, duhet ta kuptoj njëherë, ta kem njëherë në dispozicion, ta lexoj, ta kuptoj dhe pastaj mund të kem edhe pyetje.

Mund të kem një përgjigje pse është sjellë kaq vonë ky material?

Naureda Llagami: Atëherë, materiali që të është sjellë dje është përsëritje e materialit që të është dërguar një javë më përpara dhe unë do sjell Vildanin këtu, bashkë

me e-maillet përkatëse që jua kemi nisur që të gjithë anëtarëve.

Brunilda Kadi: Jo, projektvendimi dhe relacioni nuk ka ardhur një javë më përpara dhe këtë mund ta konfirmojnë të gjithë anëtarët.

Në qoftë se ju e keni, ju lutem ma konfirmoni.

Naureda Llagami: Atëherë, le të ma konfirmojë stafi. Unë di që, të paktën tek e-maili im, rezulton që kanë ardhur. Megjithatë, le ta konfirmojmë atë gjë.

Kalojmë tek çështja tjetër, derisa të kalojmë konfirmimin.

E keni fjalën për të tre projekt-aktet që lidhen me Komisionin?

Po! Okej!

(Këto 2 pika të parashikuara në rendin e ditës, pika 3 dhe pika 4, shtyhen – shih fundin e procesverbalit të pikës 7 të kësaj mbledhjeje plenare.)

* * *

(Pika 3 dhe 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 06.02.2020)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:10 dhe mbaroi në orën 12:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 5. Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit.*
- 6. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 7. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 11. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Përfaqësues të misioneve ndërkombëtare.*

RENDI I DITËS:

5. Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja tjetër që është shqyrtimi i projektvendimit për përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjorë të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë.

Siç jeni në dijeni, në mbledhjen plenare të datës 30.01.2020, Këshilli miratoi ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjorë të pranimit të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021. Në pikën 3 të këtij vendimi të miratuar në këtë mbledhje është përcaktuar se anëtarët e Komisionit të Përkohshëm zgjidhen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me propozim të bërë nga Kryetari apo çdo anëtar i Këshillit, ndërsa kryetari i Komisionit, zgjidhet nga anëtarët e tij, me propozim të Kryetarit të Këshillit. Për sa më sipër, sot duhet të bëjmë caktimin e anëtarëve të Këshillit në këtë Komision dhe ftoj anëtarët të bëjnë propozimet e tyre.

Medi Bici: Unë do propozoja që në Komision të ishte Nënkryetari i Këshillit, zoti Maks Qoku.

Naureda Llagami: Po! Faleminderit, zoti Bici!

Propozim tjetër?

Brunilda Kadi: Unë propozoj anëtarën, gjyqtare Marçela Shehu.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Kadi!

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Unë propozoj zonjën Kadi.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë propozimet. Pra propozimi i projekt-aktit është: Përbërja e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjorë të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, është si më poshtë: nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë është zoti Maksim Qoku, nga radhët e anëtarëve gjyqtarë është zonja Marçela Shehu dhe nga radhët e anëtarëve gjyqtarë është zonja Brunilda Kadi.

Anëtarët e Komisionit të Përkohshëm të marrin masat për zbatimin e kërkesave të vendimit nr.62, datë 30.01.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore të pranimit në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë”.

Jeni dakord me propozimet? Kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Këshilli vendosi sipas propozimeve të bëra.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 06.02.2020)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin në detyrë të znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:10 dhe mbaroi në orën 12:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 11. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
5. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit.*
6. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
7. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
8. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
9. *Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
10. *Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
11. *Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
10. *Përfaqësues të misioneve ndërkombëtare.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin në detyrë të znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin në detyrë të znj. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe që do relatohet nga zoti Alban Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Atëherë, në vijim të vendimit të Këshillit nr. 32, datë 23.01.2020 për kërkesën e zonjës {...} për komandim në pozicionin e ndihmësmagjistrates në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pasi mori njoftim, ka dërguar një shkresë me datë 09.01.2020, më fal 29.01.2020, ku ndër të tjera thotë që në përgjigje të njoftimit tuaj, ju përcjell qëndrimin tim për të ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, qytet ku kam edhe vendbanimin tim dhe të familjes time. Por në kushtet kur shumica e Komisionit të zhvillimit të Karrierës përbën pakicën e vendimmarrjes së Këshillit, e kemi patur të pamundur të procedojmë me një vendim, në raport me kërkesën e zonjës {...}. Kështu që, në këtë kontekst, ia adresojmë Këshillit që të procedojë me një vendimmarrje të tillë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, si do procedojmë lidhur me pjesën, duke qenë se nga ana e Komisionit nuk arrihet në një vendimmarrje.

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, meqenëse shumica e Këshillit arriti në një vendimmarrje të caktuar, në vijim të procedurës, do duhet që një nga anëtarët të bëjë një propozim konkret për përmbylljen e kësaj procedure. Mendoj që mund ta bëjë një nga ne, o unë o zonja Ukperaj, meqenëse ne ishim propozuesit e draftit të vendimit të mëhershëm.

Naureda Llagami: Po, zoti Toska faleminderit!

Zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Atëherë, në zbatim të vendimit të marrë nga mbledhja plenare seancën e kaluar, me anë të të cilit u njoh e drejta e zonjës {...} për të zgjedhur në një nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm ku ka një pozicion të lirë të përkohshëm, duke qenë se zonja {...} e ka ushtruar të drejtën duke zgjedhur pikërisht një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në zbatim të nenit 44, pika 1, shkronja “b” dhe pika 2, shkronja “b” të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, unë propozoj që:

Zonja {...} të transferohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Efektet juridike të fillimit të fillojnë ...

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është gjykatë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm...

Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.

Kopja e vendimit i njoftohet gjyqtarës sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Dhe pika 4 – Parashikohet e drejta e ankimit brenda 15 ditëve nga dita e njoftimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, kalojmë në votim të propozimit të bërë nga zonja Ukperaj.

Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Atëherë, unë do votoj pro, por më duhet të shpjegoj votën time sepse në fazën e parë të kësaj procedure unë kam qenë kundër vendimit të Këshillit, me arsyetimin që gjyqtarja duhet të ktheheshe në vendin ku ka qenë përpara komandimit, duke qenë se kishte edhe vend vakant. Por në kushtet kur Këshilli vendosi atë që ka vendosur, pra kundër kësaj që kisha unë si opinion, në fazën e dytë unë jam e detyruar që të ndjekë vendimmarrjen e Këshillit dhe faza e dytë është pikërisht caktimi në pozicionin që asaj iu dha të zgjidhte, dhe për këtë arsye votoj pro, se s’ka kuptim të votoj kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Kundër, për shkak sepse së pari nuk është respektuar neni 57, pika 4 e ligjit 96/2016, për më tepër neni 145/1 i Kushtetutës ku sanksionohet pavarësia e jashtme dhe e brendshme e pushtetit gjyqësor. Në kontekstin e pavarësisë së brendshme, siç thotë edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin 34, ajo sigurohet edhe nëpërmjet procedurave të emërimit dhe promovimit të gjyqtarëve. Kjo e fundit bëhet duke respektuar nenet përkatësisht 43 dhe 47 të ligjit “Për statusin” dhe, në rastin e zonjës {...} 25:01-02 kam parasysh nenin 43, pra që duhet të respektonim lëvizjen paralele, dhe më tej pastaj të vijonim me kërkesat e tjera që paraqiten për emërim, sidomos në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, që është edhe një gjykatë karriere.

Kështu që në këtë kontekst, duke u mbështetur edhe tek neni 17 i ligjit “Për organet kolegjiale”, ku anëtarët të cilët kanë votuar kundër një vendimi dhe kanë kërkuar shënimin e këtij fakti në procesverbal sipas paragrafit 1 të këtij neni, të përjashtohen nga çdo përgjegjësi që mund të rrjedhë nga ky vendim.

Kështu që, votoj kundër edhe për këtë vendim. Faleminderit!

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Shehu: Unë jam kundër.

Në vijim të mendimit dhe vlerësimit që kisha edhe në mbledhjen e kaluar, sipas së cilës zonja {...} duhet të kthehej në gjykatën ku ajo ushtronte detyrën e gjyqtarit përpara komandimit, në kushtet kur na rezultonte që në këtë gjykatë kishte një pozicion të lirë, përveç faktit që kemi edhe dy gjyqtarë të tjerë të transferuar nga gjykatat e tjera në Gjykatën e Kavajës.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Transferimin e gjyqtares znj. {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.

Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 06.02.2020)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:10 dhe mbaroi në orën 12:50.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 5. Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit.*
- 6. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 7. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 8. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 9. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Gentiana Bigu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 11. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Përfaqësues të misioneve ndërkombëtare.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njesisë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e radhës së rendit të ditës e cila është shqyrtimi i projektvendimit “Për komandimin e gjyqtares znj.{...} në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Fjalën ia jap zonjës Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 315, datë 19.12.2019, ka shpallur hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e gjyqtarëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, për një pozicion “këshilltar ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në zbatim të këtij vendimi kanë shfaqur vullnetin për komandim 2 gjyqtarë, për të cilët, nga ana e Këshillit, në mbledhje plenare, pasi është miratuar opinioni në lidhje me plotësimin e kushteve ligjore për komandim dhe cenimin ose jo të funksionalitetit të gjykatës, është vendosur: Vijimi i procedurave të komandimit nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale me vlerësimin e kriterëve të tjera të komandimit për gjyqtaren {...} {...} dhe përjashtimin nga kandidimi për komandim të gjyqtares {...}, për shkak se komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të gjykatës ku ajo ushtron funksionin.

Në këtë kuadër, referuar vendimit 315, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale filloi fazën e dytë të procedurës së komandimit, me qëllim kryerjen e vlerësimit vetëm të kandidatës për të cilën është lejuar vijimi i procedurave për komandim.

Në fazën e dytë procedura e komandimit vijon me vlerësimin e kriterëve të komandimit. Ky vlerësim, sipas nenit 305 (*lapsus, pasi është vendimi nr. 305*), datë 19.12.2019 u bë mbi baza dokumentare nga ana e Komisionit, bazuar në të dhënat e dosjes personale dhe dokumentacioni i depozituar rishtazi në KLGJ nga gjyqtarja bashkangjitur kërkesës për komandim, pa u vlerësuar i nevojshëm intervistimi.

Gjatë procedurës së vlerësimit Komisioni pati parasysh kriteret preferenciale të

parashikuara në vendimin 315, sipas të cilit: Ka përparësi kandidati që plotëson këto kritere: Ekspertizë të veçantë në fushën e hartimit të akteve rregullatore; Ka njohuri mbi legjislacione të vendeve të Bashkimit Evropian, mbi akte ndërkombëtare dhe mbi jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemin gjyqësor; Është autor i artikujve ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës; Ka njohuri të mira të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian; Ka aftësi të mira profesionale, organizative, personale, si dhe etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale.

Gjyqtare {...} {...} ushtron detyrën e gjyqtarit që prej shtatorit 2004, me një eksperiencë pune mbi 15-vjeçare, të cilën ajo e ka ushtruar në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm Durrës, Vlorë dhe Tiranë. Aktualisht ajo gjykon në Seksionin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, por që ka gjykuar në shkallë të parë të gjitha kategoritë e çështjeve gjyqësore (veç administrative), si: gjyqtare e seksionit penal në periudhën 2004-2007, seksionit familjar në periudhën 2007-2008 dhe atij civil të përgjithshëm në periudhën 2009-2013. Është vlerësuar 2 herë shumë mirë për veprimtarinë e saj etike-profesionale në periudhat e vlerësimit 2005-2006 dhe 2007-2009 dhe referuar informacioneve periodike të dërguar nga kryetarët e gjykatave, të paktën për vitin 2019, që ne kemi në administrim, ka përballuar një ngarkesë pune relativisht të lartë. Ka njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe italiane (këto të dhëna të referuara nga vetë gjyqtarja). Nga pesë dokumentet ligjore të paraqitur prej saj konkludohet se ka aftësi shumë të mira profesionale. Në çdo dokument ligjor, gjyqtarja i referohet pretendimeve dhe të dhënave që janë shqyrtuar gjatë procesit gjyqësor, përmend dhe analizon bazën ligjore mbi të cilën zgjidhet mosmarrëveshja dhe analizohen provat në drejtim të saj. Të pesë dokumentet ligjore janë të mirëstrukturuara, të rregullt në formë dhe të qartë në përmbajtje. Pjesët e vendimit kanë lidhje dhe janë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Nuk gjen në pjesën arsyetuese kundërthënie argumetash apo mospërputhje me pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parime dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik.

Nisur nga mënyra e arsytimit të dokumenteve ligjore, pavarësisht se nga ana e Komisionit nuk është bërë një vlerësim i dosjeve konkrete, konstatohet gjithashtu që gjyqtarja ka aftësi të mira organizative. Ajo është ndjekëse e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës dhe atyre të organizuar nga organizata të tjera ndërkombëtare, çka tregon se ka angazhim ndaj vlerave të saj profesionale.

Ka eksperiencën në hartimin e akteve rregullatore në fushën e procedurës civile dhe atij të falimentit. Po ashtu është për t'u vlerësuar kontributi i saj në hartimin e të modeleve të akteve procedurale, nevojshmëria e të cilave ka lindur pas ndryshimeve të Kodit të Procedurës Civile, akte që sot përdoren nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, nuk rezultojnë të dhëna mbi njohuri të legjislacionit të vendeve të Bashkimit Evropian, apo akte ndërkombëtare në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor. Nga ana tjetër, nuk rezulton që kjo gjyqtare të jetë autore apo bashkautore në ndonjë artikull apo botim shkencor në fushën e jurisprudencës.

Referuar të dhënave të mësipërme, Komisioni ka vlerësuar se kjo gjyqtare shfaq aftësi shumë të mira profesionale, organizative, personale, si dhe etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale dhe ka eksperiencën personale në draftimin e akteve rregullatore. Për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit apo edhe të veprimtarive të tjera jashtë këtij funksioni, shfaq aftësi interpretuese dhe zbatuese të ligjit si dhe aftësi teknike për kërkime ligjore mbi legjislacione të vendeve të Bashkimit Evropian, akte ndërkombëtare apo jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor. Nga ana tjetër referuar kritereve preferencialë të parashikuar në piken 5 të vendimit të mësipërm, në rastin konkret nuk mund të bëhet një renditje e gjyqtarëve, pasi pozicionet e shpallura të lira për komandim (numri i pozicioneve) është i njëjtë me numrin e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet e kriteret e komandimit (kemi një pozicion dhe kemi një gjyqtar të kualifikuar për komandim).

Sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale i

propozon Mbledhjes Plenare: Komandimin e gjyqtares {...} {...} në pozicionin e “këshilltarit ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Afati i komandimit është 2 vjet. Duke marrë në konsideratë nevojshmërinë që ka struktura dhe ritin e shqyrtimit gjyqësor sipas Kodit të Procedurës Civile, ku ndryshimi i trupit gjykues si rregull nuk përbën shkak për fillimin e gjykimit nga e para, komandimi propozohet të fillohet në datë 10.02.2020.

Komisioni propozon gjithashtu, që deri në fillimin e periudhës së komandimit, gjyqtarja duhet të përjashtohet nga procedurat e ndarjes së çështjeve me short në gjykatë.

Ky është propozimi i Komisionit.

Naureda Llagami: Kemi ndonjë diskutim paraprak?

Nëse jo, atëherë kalojmë në...?

Erjon Muharremaj: Kisha vetëm diçka në lidhje me korrigjimin e mbiemrit të gjyqtares, pasi {...} është mbiemri i saj i vajzërisë. Kështu që propozoj që në akt të vendoset mbiemri i saj {...}.

Tek shqyrtimi i projektvendimit thuhet “për komandimin e gjyqtares {...}”. Kopja që kam unë të paktën.

Brikena Ukperaj: Është gabim i rendit të ditës, por jo i aktit. Akti është ky që ne kemi miratuar në Komision.

Erjon Muharremaj: Okej! Në rregull. Dakord.

Naureda Llagami: Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Komandimin e gjyqtares {...} {...} në pozicionin e “këshilltarit ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Periudha e komandimit është 2 vjet dhe fillon në datë 10.02.2020.

Përfundimin e menjëhershëm të gjyqtares {...} {...} nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore me short në gjykatë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

(Anëtarët e Këshillit i rikthehen pikës së tretë dhe të katërt për të cilat u la për t’u verifikuar nga administrata.)

Tani, lidhur me tre projekt-aktet që kanë të bëjnë me pjesën financiare, duke qenë se rezultoni nga ana e Komisionit janë miratuar, por nga ana e administratës nuk janë përcjellë në datën e miratimit nga ana e Komisionit, gjë që për të cilën do merren masa disiplinore dhe përgjegjësi për administratën, propozoj shtyrjen e këtyre në mbledhjen e radhës. Jeni dakord?

Dakord.

Atëherë, nëse nuk keni ndonjë gjë për të diskutuar, mbledhjen e konsideroj të mbyllur. Faleminderit!

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor